



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.694/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve EuroSig, me seli në Prishtinë, rr. “2 Korriku”, kundër debitorit të përmbarimit EuroMed Group d.o.o., me seli në Prishtinë, rr. ”Nëna Terezë”, në çështje përmbarimore, objekti i përmbarimit kërkesa në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm- Divizion Civil, PPP.nr.554/20, të datës 18.06.2021, me datë 17.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit Kompania e Sigurimeve EuroSig, me seli në Prishtinë, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm- Divizion Civil, PPP.nr.554/20, të datës 18.06.2021 dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm- Divizion Civil, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.554/20, të datës 18.06.2021, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit EuroMed Group d.o.o., me seli në Prishtinë, kundër urdhërit përmbarimor I.nr.845/19 të datës 13.11.2019 të përmbaruesit privat Atip Mjeku me seli në Prishtinë, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka shfuqizuar urdhrin përmbarimorë I.nr.845/19 të datës 13.11.2019 të përmbaruesit privat Atip Mjeku me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të LPP-së dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi PPP.nr.554/20, të datës 18.06.2021 dhe të refuzohet prapësimi i debitorit dhe urdhrin për përmbarrim I.nr.845/19 të datës 13.11.2019 të mbetet në fuqi ose çështja kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Kreditori i përmbarrimit, ka parashtruar propozim për përmbarrim në zyrën e përmbarruesit privat Atip Mjeku me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbarrimit, që t'ia paguaj shumën prej 826.00€ dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore. Propozimin për përmbarrim e kishte bazuar në Faturën Nr.018223 të datës 06.23.2017. Përmbarruesi më 13.11.2019 e ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor I.nr.845/19 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarrimin sipas propozimit.

Debitori në afat ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarrimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbarrimor. Ai ka pretenduar se, asnjëher nuk e ka shfrytëzuar polisën e sigurimit të kreditorit, prandaj nuk mund të paguajë borxhin i cili na është faturuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin. Ai ka pretenduar se, bëhet fjalë për sigurimin individual vullnetar Kasko, të një ngjarje që e cila mundë të ndodhë gjatë periudhës së sigurimit e nuk është sigurimi i detyrueshëm, gjithashtu debitori ka pranuar që ka qenë në marrëdhënie kontraktore me kreditorin, andaj i propozojmë gjykatës që ta refuzoj prapësimi si të pa bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankmuar PPP.nr.554/20, të datës 18.06.2021, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit EuroMed Group d.o.o., me seli në Prishtinë, kundër urdhërit përmbartimor I.nr.845/19 të datës 13.11.2019 të përmbartuesit privat Atip Mjeku me seli në Prishtinë, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimorë I.nr.845/19 të datës 13.11.2019 të përmbartuesit privat Atip Mjeku me seli në Prishtinë. Me arsyetim se nga shkresa e lëndës gjykata ka konstatuar se në rastin konkret bëhet fjalë për kontest nga kontratat e sigurimit, që për zgjidhjen e së cilës është kompetente gjykata civile, sipas rregullave të procedurës civile, duke u bazuar në nenin 1 të LPK-së dhe nenin 1 të LPP-së, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, dhe në kundërshtim të nenit 182 pika n) si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pik n), kjo për faktin se dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktvendimit, ngase gjykata e shkallës së parë në rastin konkret është dashur që ta ketë pasur marrëdhënie kontraktore që kanë pasur mes kreditorit dhe debitori, ku pikërisht nga kjo kontratë e lidhur me dëshirën e debitori, ka pasuar tek polisa e sigurimit Kasko, që është nënshkruar në mënyre vullnetare dhe jo me detyrim, ku gjithashtu polisa Kasko, nuk bëhet në mënyrë detyrimitisht shfrytëzuese, po me mundësi potenciale për shfrytëzim që mundë të ndodhë në të ardhmen, për periudhën e sigurimit. Më konkretisht Fatura Nr.018223 të datës 06.23.2017 si dokument i besueshëm në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim rezulton se është pranuar nga debitori përkatësisht e njëjta përmban nënshkrimin e pranuesit – debitorit, andaj gjykata e shkallës së parë është dasht të vlerësoi se a i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par. 1 nën para. 1.3 të LPP-së ku përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm dhe dokument i besueshëm sipas këtij ligji është fatura”*, ndërsa neni 29 par. 3 të LPP-së thuhet se : *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar*

kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Andaj, duke qenë së debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, atëherë gjykata e shkallës së parë është dasht të vlerësoj se si e tillë e njëjta a mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe se a ka tipare të përmbarueshmërisë. Po ashtu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur që të vërtetoj të gjitha faktet dhe provat nga shkresat e lëndës, prapësimi dhe përgjigjet të prapësimi të palëve ndërgjygjëse, dhe me pastaj të vendoste lidhur me këtë çështje.

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata e shkallës së dytë duke e pranuar si të themeltë pretendimin ankimore në këtë drejtim, çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palës kreditore, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit nga ana e përmbaruesit privat, e më pastaj ka mundësi që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Shk.II.nr.694/23, me datën 17.04.2024

**Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri**